

W
R
UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca plenare

Seanca nr. 02-01/94

Prishtinë, më 3 dhjetor 2004

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

Seancën konstituive e kryesoi deputeti më i moshuar, akademik Mark Krasniqi, kurse e ndihmoi deputetja Nekibe Kelmendi.

Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 109 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryesuesi, në fillim të seancës, i përshëndeti deputetët e kësaj legjislature, PSSP, z. Soren Petersen dhe zëvendësin e tij, përfaqësuesit e zyrave diplomatike në Prishtinë, komandanitin e KFOR-it, përfaqësuesit e bashkësive fetare dhe të gjithë të pranishmit.

Kryesuesi e ftoi PSSP z. Petersen tu drejtohej deputetëve me një fjalë rasti.

PSSP z. Petersen ia uroi zgjedhjen kësaj legjislature duke u dëshiruar punë të frytshme gjatë këtij mandati.

Ai i informoi deputetët e Kuvendit për rrjedhën e takimit që kishte pasur në KS të OKB – së, ku ai kishte referuar për gjendjen në Kosovë, si dhe për përkrahjen që ua kishte dhënë KS atij dhe institucioneve vendore për zbatimin e standardeve dhe për vlerësimin e tyre në mesin e vitit 2005, në bazë të të cilit do të zhvillohen bisedimet për statusin e ardhshëm të Kosovës.

Ai e falënderoi edhe Qeverinë e mëparshme për punët e kryera gjatë mandatit të saj. Fjala e plotë e z. Petersen i është bashkangjitur transkriptit.

Pastaj kryesuesi i informoi deputetët për propozimin e rendit të punës të kësaj seance.

1. Emërimi i Kryesisë dhe i kryetarit të Kuvendit të Kosovës

Kryesuesi i informoi deputetët për procedurat e propozimit të anëtarëve të Kryesisë dhe të kryetarit të Kuvendit.

LDK – dy anëtarë, meqë ka fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet parlamentare, duke deklaruar se njëri prej tyre do të emërohet kryetar i Kuvendit;

PDK – dy anëtarë, si parti e dytë me numrin e fituar të votave;

AAK – një anëtar, si parti e tretë me numrin e fituar të votave;

Ora – një anëtar si parti e katërtë me numrin e fituar të votave;

Një anëtar nga radhët e deputetëve të partive që janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb;

Një anëtar nga radhët e komunitetit joshqiptar dhe joserb në Kosovë, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre.

Ai kërkoi nga kryetarët e partive politike t'i propozonin emrat e kandidatëve për anëtar të Kryesisë.

Ibrahim Rugova, në emër të LDK-së, për anëtar të Kryesisë e propozoi Fatmir Sejdiun, kurse për kryetar të kuvendit Nexhat Dacin.

Kryetar i Grupit Parlamentar të LDK-së do të jetë Alush Gashi.

Hashim Thaçi, në emër të PDK-së, për anëtarë të Kryesisë së Kuvendit i propozoi Ramë Bujën dhe Xhavit Halitin, kurse për kryetar të Grupit Parlamentar, Jakup Krasniqin.

Veton Surroi, në emër të Lëvizjes "ORA", për anëtar të Kryesisë së Kuvendite propozoi Gazmend Muhaxherin.

Sllavisha Petkoviq, tha se përfaqësuesit e komunitetit serb, pasi t'i harmonizojnë qëndrimet ndërmjet subjektit të tyre, në një seancë tjetër do ta propozojnë anëtarin e Kryesisë së Kuvendit.

Mahir Jakxhilar, në emër të tri subjekteve politike: KDTP, „Vakat“, IRDK, për anëtar të Kryesisë së Kuvendit e propozoi deputetin Xhezair Murati.

Kryesuesi i hodhi në votë këto propozime. Rezultati ishte si vijon:

Për-----99;

Kundër-----7;

Abstenime---3.

Kryesuesi konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, i emëroi anëtarët e Kryesisë dhe kryetarin e Kuvendit.

Kryesuesi dha pauzë pesëmbdhjetëminutshe.

Pas pauzës, seancën e kryesoi **Nexhat Daci**, kryetar i Kuvendit, kurse e ndihmoi **Naim Maloku**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari, në emër të Kryesisë së posazgjedhur dhe në emër të tij, i falënderoi deputetët e Kuvendit për besimin e dhënë.

Ai premtoi bashkëpunim të sinqertë, profesional, demokratik dhe njerëzor me të gjitha grupet parlamentare në punën e këtij legjislativi.

2. Zgjedhja e kryetarit të Kosovës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e LDK-së, partia që kishte fituar më së shumti deputetë në Kuvendin e Kosovës, ta propozonin kandidatin e tyre për kryetar të Kosovës.

Kolë Berisha, në emër të LDK-së, për kryetar të Kosovës e propozoi dr. Ibrahim Rugovën.

Xhavit Haliti tha se edhe PDK-ja do ta propozojë kandidatin e saj për kryetar të Kosovës, por para se të votohet për ta, duhet të hapet debat për kandidatët e propozuar.

Emrush Xhemajli, në emër të LPK-së, kërkoi nga LDK-ja ta propozojnë një kandidat tjetër për kryetar të Kosovës.

Numan Baliq shprehu pakënaqësinë e tij lidhur me propozimin e anëtarit të Kryesisë nga radha e komuniteteve joshqiptare dhe joserbe, ngase sipas tij nuk janë konsultuar përfaqësuesit e këtyre partive.

Ai pati vërejtje edhe për kandidatin që ishte propozuar për ministër të Shëndetësisë.

Hashim Thaçi, në emër të PDK-së, e përshëndeti ndërtimin e institucioneve të reja të Kosovës. Ky Kuvend duhet të jetë vend i debateve dhe i alternativave që do të përshpejtojë ndërtimin e rendit demokratik, të institucioneve shtetërore të Kosovës. PDK-ja ishte përcaktuar në favor të ndërtimit të institucioneve me bazë të gjerë politike, përfaqësim të partive kryesore politike shqiptare dhe përfaqësim shumetnik. Ky solucion qeverisës do të ishte solid dhe adekuat për aktualitetin dhe për perspektivën trivjeçare të vendit.

PDK-ja do të jetë opozitë reale e ofertës dhe e alternativave, ne do të punojmë që t'i gjejmë pikat e bashkëpunimit e jo të konfrontimit. Dhe nëse dje PDK-ja ishte model i bashkëqeverisjes, sot ne do të jemi shembull i opozitës për partitë politike se si duhet të sillen në procesin demokratik të rotacionit pozitë-opozitë.

Fjalimi i plotë i z. Thaçi i bashkangjitet transkriptit.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, për kryetar të Kosovës e propozoi z. Ramë Buja.

Veton Surroi, në emër të Grupit Parlamentar «ORA» kërkoi, para se të votohej për kandidatët për kryetar të Kosovës, që ata ta paraqesin vizionin e punës së tyre të ardhshme trevjeçare.

Pas këtyre propozimeve dhe diskutimeve, **kryetari** i ftoi, një nga një, deputetët e Kuvendit të deklaroheshin, me votim të fshehtë, për kandidatët e propozuar për kryetar të Kosovës.

Komisioni i votimit i përbërë prej tre vetave nga Sekretaria e Kuvendit dhe nga një vëzhgues nga secili Grup Parlamentar, filloi zbatimin e procedurës së votimit.

Pas numërimit të votave, **kryetari** e deklaroi rezultatin e tyre, si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 108 deputetë.

«Për» dr. Ibrahim Rugovën kanë votuar 65 deputetë;

«Për» Ramë Bujën kanë votuar 34 deputetë;

Të pavlefshme ka qenë një fletëvotimi.

Sipas këtij rezultati, procedura e votimit duhet të përsëritet sipas kreut 9.2.8 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullës 14.4 të Rregullores së punës të Kuvendit.

Në rrethin e dytë të votimit, kryetari i ftoi deputetët, një nga një, që të deklaroheshin, me votim të fshehtë, për kandidatët për kryetar të Kosovës.

Pas numërimit të votave nga Komisioni i votimit, **kryetari** e deklaroi rezultatin e tyre, si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 100 deputetë.

«Për» dr. Ibrahim Rugovën kanë votuar 63 deputetë.

«Për» Ramë Bujën kanë votuar 34 deputetë.

Të pavlefshme janë tri fletëvotimi.

Të pranishëm në sallë janë 106 deputetë.

Sipas këtij rezultati, procedura e votimit duhet të përsëritet sipas kreut 9.2.8 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullës 14.5 të Rregullores së punës të Kuvendit.

Jakup Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deklaroi tëreqjen e kandidatit të tyre nga rrethi i tretë i votimit për kryetar të Kosovës.

Në rrethin e tretë të votimit, **kryetari** ftoi, një nga një, deputetët e Kuvendit që të deklarohen, me votim të fshehtë, për kandidatin e LDK-së për kryetar të Kosovës.

Pas numërimit të votave nga Komisioni i votimit, nën mbikëqyrjen e përfaqësuesve të grupeve parlamentare, **kryetari** e deklaroi rezultatin e votimit, si vijon:

- Në votim kanë marrë pjesë 99 deputetë.

- «Për» - kanë votuar 64 deputetë;
- «Kundër» - kanë votuar 32 deputetë dhe
- Të pavlershme janë 3 fletëvotimi.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e zgjodhi kryetar të Kosovës dr. Ibrahim Rugovën.

Kryetari e ftoi kryetarin e Kosovës t'u drejtohej deputetëve të Kuvendit.

Dr. Ibrahim Rugova: Ju falënderoj për besimin e dhënë që edhe në mandatin e ardhshëm ta udhëheqi vendin. Betohej solemnisht se do ta ruaj dhe do ta mbroj integritetin territorial të Kosovës dhe unitetin e popullit. Do të angazhohem për zhvillimin ekonomik dhe demokratik, për stabilitetin, prosperitetin dhe mirëqenien e të gjithë qytetarëve. Do të punoj për njohjen sa më të shpejtë të pavarësisë dhe integritetit të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe në NATO, si dhe për forcimin e miqësisë së përhershme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

3. Zgjedhja e kryeministrit të Kosovës dhe e ministrave së Qeverisë të Kosovës

Kryetari tha se në bazë të marrëveshjes së partive partnere në koalicion, si dhe në përputhje me kreun 9.3.8 dhe 9.3.9 të Kornizës Kushtetuese, e ftoj kryetarin e Kosovës, zotin Rugova që ta propozojë kandidatin për kryeministër të Kosovës.

Ibrahim Rugova: në bazë të komptencave kushtetuese dhe në bazë të marrëveshjes së Koalicionit ndërmjet të LDK-së, AAK-së dhe partnerëve të tjerë të koalicionit, kam vendosur ta nominoj zotin Ramush Haradinaj kryeministër të Qeverisë së Kosovës, si dhe kam kërkuar nga kryeministri i nominuar që ta formojë Qeverinë në bazë të marrëveshjes së koalicionit.

Kryetari e ftoi kandidatin e propozuar për kryeministër të Kosovës që ta paraqiste listën e ministrave të Qeverisë.

Ramush Haradinaj: në bazë të marrëveshjes së koalicionit dhe të kërkesës së kryetarit të Kosovës, e kam marrë përsipër formimin e Qeverisë së Kosovës me ministrat, si vijon:

- zëvendëskryeministër, z. Adem Salihaj;
- ministër të Ekonomisë dhe të Financave, z. Haki Shatri;
- ministër i Shërbimeve Publike, znjsh. Melihate Tërmkollli;
- ministër i Pushtetit Lokal, z. Lutfi Haziri;
- ministër i Transportit dhe i Telekomunikacionit, z. Qemajl Ahmeti;
- ministër i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, z. Agim Veliu;
- ministër i Kulturës, i Rinisë dhe i Sporteve, z. Astrit Haraçia;
- ministër i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, z. Bajram Kosumi;
- ministër i Energjetikës dhe i Minierave, z. Et'hem Çeku;
- ministër i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, z. Ahmet Isufi;

- ministër i Industrisë dhe i Tregtisë, z. Bujar Dugolli;
- ministër i Shëndetësisë, z. Sadik Idrizi.

Po ashtu, më lejoni, t'ju informoj se dy ministri janë paraparë të udhëhiqen nga serbët e Kosovës. Meqenëse ministrat ende nuk janë nominuar, ne kemi paraparë emërimin e zëvendësministrave në seancën e radhës të Kuvendit, si dhe të zëvendësministrave të tjera ministrive.

Kryetari i ftoi deputetët e Kuvendit të deklaroreshin për kryeminitrin e Kosovës dhe për ministrat e Qeverisë së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----72;
Kundër----- 2;
Abstenime----- 5.

Kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, i zgjodhi kryeministrin dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës.

Jakup Krasniqi, kryetar i Grupit Parlamentar të PDK-së, paraqiti qëndrimin dhe pikëpamjet lidhur me kabinetin e sapoformuar qeveritar. Fjalimi i plotë i tij i është bashkangjitur transkriptit.

Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 15:10 minuta.

Sektori për Çështje Plenare dhe Procedurale

Kryetari i Kuvendit të Kosovës
Akademik Nexhat DACI
